



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 480 Akti

Nr. 596 Vendimi

Tiranë, më 9.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 7.12.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artan Jahollari**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe

grykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 7.12.2022, kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **VËREN:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, në datën 15.6.2020, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Lidhur me faktin nëse z. Artan Jahollari i plotësonte apo jo kriteret për të pasur statusin e subjektit të rivlerësimit dhe kësisoj për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, ka diskutuar dhe vlerësuar rrethanat faktiko-ligjore, si dhe kontestin në momentin e nisjes së karrierës profesionale të tij dhe me shumicë votash, nëpërmjet vendimit të ndërmjetëm nr. 2, ka vendosur kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj z. Artan Jahollari.
6. Shkaqet, për të cilat shumica vendosi vijimin e procesit të rivlerësimit për z. Artan Jahollari, konsistojnë sa më poshtë:
  - i. Sipas të dhënave nga formulari i vetëdeklarimit dhe nga dokumentet e tjera të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se z. Artan Jahollari në periudhën tetor 2013 – tetor 2015 ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga vetë pohimet e subjektit Artan Jahollari në periudhën tetor 2015 - gusht 2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Tiranë (stazhin profesional), konkretisht në dhomën civile.
  - ii. Komisioni administroi Dekretin Nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet të cilit z. Artan Jahollari është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nisur nga ky moment e në vijim, z. Artan Jahollari ka shqyrtuar çështje të ndryshme dhe të shumta, duke vendosur i vetëm lidhur me themelin e tyre. Kësisoj, ai ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në sistemin e drejtësisë shumë kohë përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016, si dhe ndryshimet kushtetuese, që kanë parashikuar dhe rregulluar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
  - iii. Rrethanat e lartpërmendura – të para nën optikën e një vlerësimi krahasimor dhe të analizuara në harmoni me frymën e ligjit dhe për analogji, në raport me aktivitetin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (gjithashtu të cilësuar si subjekte rivlerësimi *ex officio*, në nenin 179/B, pika 4 e Aneksin e Kushtetutës) – përbëjnë më shumë shkaqe legjitimuese për kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj gjyqtarëve stazhierë, thjeshtë për faktin se këta të fundit kanë shqyrtuar të vetëm dhe kanë dhënë vendime mbi çështjet gjyqësore përkatëse, ndërsa këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë kanë qenë të përfshirë në një funksion jo vendimmarrës, por thjesht dhe vetëm ndihmës apo përgatitorë/sugjerues.
  - iv. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se lidhur me subjektet *ex officio* dispozita përkatëse, në pikën 3 të nenit të lartpërmendur, shprehet me terma të përgjithshëm gjyqtarë, prokurorë etj., pa bërë dallim midis gjyqtarëve stazhierë dhe atyre të emëruar pas kryerjes së stazhit profesional, duke lënë kësisoj vend për interpretim ligjorë.

- v. Në këto kushte, interpretimi dhe vlerësimi i rastit konkret, nisur nga sa u përshkrua më sipër, si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe faktin se z. Artan Jahollari ka plotësuar dhe dorëzuar rregullisht dhe në kohë deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, prej vitit 2015, e të tjerat në vijim, përfshirë edhe deklaratat, formularët dhe dokumentet e kërkuara pikërisht pas futjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, për të plotësuar kuadrin faktik, vlen të përmendet që z. Artan Jahollari ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues dhe është përgjigjur aktivisht, sa herë që është pyetur përgjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk ka pretenduar ndonjëherë se nuk ishte subjekt rivlerësimi. Kësisoj edhe vullneti i z. Artan Jahollari ka qenë për rivlerësimin e tij, duke u aktivizuar në këtë drejtim dhe, për rrjedhojë, moskryerja e rivlerësimit të tij mund të pengonte apo ngadalësonte edhe vijimin e karrierës së tij si magjistrat. Gjithashtu, përjashtimi nga procesi i rivlerësimit të z. Artan Jahollari do të shkonte kundër frymës së ligjit dhe Reformës në Drejtësi që ka pasur si qëllim parësor vijueshmërinë e karrierave/funksioneve të vetëm atyre aktorëve e komponentëve të këtij sistemi gjyqësor, që do të kalonin me sukses procesin e rivlerësimit, nëse ata më herët ishin të përfshirë dhe aktivë në sistemin gjyqësor [edhe nëse jo vendimmarrës – si në pikën (iii)], para futjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016.
7. Gjatë hetimit administrativ dhe, konkretisht, në datën 21.7.2020, u njoftua subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 23.7.2020, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.
8. Në datën 14.11.2022, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, diskutoi në lidhje me juridiksionin rivlerësues ndaj subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari dhe pas diskutimeve të gjera, bazuar në legjislacionin në fuqi, me shumicë votash, me vendimin nr. 2, datë 14.11.2022, vendosi të vijojë procesin e rivlerësimit të subjektit Artan Jahollari.
9. Në vijim të diskutimeve dhe përmbajtjes së rezultateve të prezantuara u vlerësua që t'i kërkohet subjektit të rivlerësimit paraqitja e dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, si dhe vendimi i ish-KLD-së, lidhur me emërimin e tij si stazhier pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
10. Komisioni, në datën 14.11.2022, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për shkak të nevojës për informacione shtesë në funksion të vijimit të procesit të rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të vinte në dispozicion një kopje të Dekretit nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, lidhur me emërimin e tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e stazhit profesional, si dhe një kopje të dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të vendimit të ish-KLD-së, lidhur me emërimin e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

11. Po ashtu, Komisioni iu drejtua edhe Institucionit të Presidencës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2022, duke i kërkuar vënien në dispozicion të Dekretit Nr. \*\*\*, viti 2015, të Presidentit, si dhe dekretin e vitit 2017, që ka emëruar subjektin e rivlerësimit gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Institucioni i Presidentit të Republikës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, vuri në dispozicion Dekretin nr. \*\*\*, viti 2015, ndërsa lidhur me dekretin e vitit 2017 bëri me dije se pranë këtij institucioni nuk rezulton të jetë administruar një i tillë.
12. Subjekti i rivlerësimit, në po të njëjtën datë, 14.11.2022, nëpërmjet postës elektronike informoi se dispononte vetëm një kopje të njoftimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 10.2.2017, të KLGJ-së për emërimin e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, së bashku me procesverbalin e mbledhjes së ish-KLD-së, datë 10.2.2017, për diskutimin dhe votimin si magjistratë të diplomuar në vitin 2016 nga Shkolla e Magjistraturës, ku bën pjesë edhe ai. Ndërsa për sa i përket Dekretit Nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, për emërimin e tij si gjyqtar stazhier pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk dispononte kopje, pasi nuk i është njoftuar.
13. Në vijim të mbledhjes, Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 21.11.2022, në kushtet kur trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar u njohën me përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nëpërmjet pyetësorit nr. 3, por edhe të përgjigjes së Institucionit të Presidentit të Republikës dhe vendimit të KLD-së, të aksesuar *online*, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
14. Më tej, në datën 22.11.2022, nëpërmjet postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe e ftoi atë të njihej me dosjen (të drejtë të cilën subjekti nuk e ushtroi) dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 30.11.2022, ora 16:00.
15. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në datën 24.11.2022, nëpërmjet vendimit nr. 4, datë 30.11.2022, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 7.12.2022, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

1. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 7.12.2022, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.
2. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët

me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 7.12.2022 u mbyll, për të rifilluar në datën 9.12.2022 për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimit të mbylljes së hetimit administrativ; (viii) argumentet e paraqitura në seancë dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose

përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

### **1. Tokë bujqësore me sipërfaqe 16 dynym, në M\*\*\*, Korçë**

1. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* si pasuri e llojit “tokë bujqësore, arra dhe pemëtore”, me sipërfaqe 16 dynym, nga e cila pjesa takuese e tij rezulton të jetë 25%, pasuri kjo e përfutur me anë të AMTP-së nr. \*\*\*.
2. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur AMTP-në e sipërcituar, sipas së cilës në mbështetje të ligjit për tokën nr. 7501, datë 19.7.1991, babait të subjektit, z. Sh. J<sup>1</sup>, i është dhënë në pronësi tokë bujqësore përkatësisht, tokë arë me sip. 7.200 m<sup>2</sup> dhe 500 m<sup>2</sup>; pemëtore me sip. 8.320 m<sup>2</sup> dhe 1.600 m<sup>2</sup>, si dhe vreshtë me sip. 400 m<sup>2</sup>, të ndodhura në Komunën M\*\*\*, Korçë.
3. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK – Korçë ka rezultuar se me shkresat nr.\*\*\* prot., datë 15.9.2020, ZQRPP-ja<sup>2</sup> nr. \*\*\*, datë 28.12.2017, si dhe ZVRPP Korçë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2017, kanë bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme<sup>3</sup>.
4. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të bënte me dije nëse mbi pasurinë me sip. 16 dynym janë kryer ndërtime apo investime. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se mbi këtë pasuri, ku pjesa e tij takuese është 4 dynym, nuk është kryer asnjë investim dhe se tokat janë lënë të papunuara.
5. Nga hetimi administrativ lidhur me pasurinë e sa më sipëranalizuar, Komisioni arrin në përfundimin se nuk është konstatuar ndonjë problematikë lidhur me përfitimin, deklarin apo ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë në fjalë, për sa kohë pasuria në bashkëpronësi rrjedh nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

### **2. Apartament banimi në përdorim, i ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë**

6. Subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e të dhënave personale të deklaratës *Vetting*, ka deklaruar si adresë të vendbanimit, Rrugën e \*\*\*, ish-\*\*\*, qendra “\*\*\*\*”, kulla \*\*\*, apartamenti nr. \*\*, Tiranë, pasuri kjo në pronësi të prindërve të tij. Komisioni ka konstatuar se ndonëse subjekti ka deklaruar këtë pasuri si adresë vendbanimi, kjo pasuri nuk është deklaruar prej tij në përdorim, ndryshe nga përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.

<sup>1</sup> Sh. (I.) J. – babai i subjektit të rivlerësimit.

<sup>2</sup> ZQRPP-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2017, 9.11.2017, 28.12.2017 dhe 28.2.2018, ka bashkëlidhur përgjigjet negative të ZVRPP-ve të rretheve dhe po ashtu edhe ALUIZNI, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2017, konfirmon se shtetasi Artan Jahollari nuk ka aplikuar për proces legalizimi të ndonjë objekti informal.

<sup>3</sup> ASHK Korçë ka informuar gjithashtu se në emër të nënës së subjektit, znj. P. J., rezulton 1/25 pjesë takuese në pasuritë e përfutur me anë të trashëgimisë ligjore, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, tokë-arë, me sip. 3.360 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\*, tokë-arë me sip. 4.040 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\*, tokë-arë me sip. 1.403 m<sup>2</sup>, pasuria nr. \*\*\* arë, me sip. 380 m<sup>2</sup>, truall me sip. 200m<sup>2</sup> dhe 110 m<sup>2</sup> ndërtesë; pasuria nr. \*\*\*, tokë-arë me sip. 10.586 m<sup>2</sup>.

7. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka informuar se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, informacion i cili konfirmohet edhe nga kërkimi *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së, se nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme, të regjistruara në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, në vijim të hetimit administrativ ka rezultuar se edhe nga verifikimi nga FSHU-ja dhe UKT-ja nuk figurojnë kontrata furnizimi me energji elektrike apo të furnizimit me ujë në emër të subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari dhe personave të lidhur me të.
8. Referuar përgjigjeve të pyetësorit<sup>4</sup> nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka informuar se prej momentit të fillimit të detyrës si gjyqtar stazhier pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka banuar në shtëpinë në pronësi të prindërve<sup>5</sup>, pasuri e ndodhur në Rrugën e \*\*\*, ish-\*\*\*, qendra “\*\*\*\*”, kulla \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë.
9. Për të provuar sa më sipër ka deklaruar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin hipotekor të pasurisë, sipas të cilit rezulton se apartamenti është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 6.11.2009, me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me sip. 89 m<sup>2</sup>, në emër të nënës së subjektit, znj. P. J.
10. Komisioni, në vijim të hetimit administrativ nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, iu drejtua ASHK Tiranë Jug, e cila me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022, vuri në dispozicion dosjen e pasurisë së llojit “apartament”, ku nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë<sup>6</sup> ka rezultuar se pronësia mbi këtë apartament është fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 12.10.2009, të lidhur midis palës blerëse, nënës së subjektit, dhe palës shitëse, shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit 27.590 euro. Në këtë kontratë shitblerjeje palët janë shprehur se çmimi është likuiduar me këste, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 2.9.2005.
11. Për sa më sipër, duke mbajtur në vëmendje rrethanat faktiko-ligjore se apartamenti në fjalë është blerë/paguar vetëm prej prindërve të subjektit, së paku 6 vjet përpara emërimit

<sup>4</sup> Në përgjigjet të pyetësorit subjekti ka informuar se pas emërimit gjyqtar në vitin 2017 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka jetuar në apartamentin me qira në Pogradec, më pas, nga muaji tetor i vitit 2017 ka marrë një apartament tjetër me qira shtetasit S. K. Ndërsa lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, në përgjigje të kërkesave të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2022 dhe datë 19.10.2022, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2022, kanë bërë me dije se nga verifikimi nuk rezulton të këtë procedime penale apo çështje civile të shqyrtuara në emër të shtetasve dhe subjekteve si: Xh. D., V. D., A. Ç., S. K., A. A., Xh. D., L. G., S. V., V. K.

<sup>5</sup> ASHK Tirana Veri, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020 dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, kanë bërë me dije se në emër të shtetasve I. dhe P. J. figuron e regjistruar një pasuri e llojit njësi me nr. \*\*\*, me sip. 56 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, e përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së datës 5.4.2005, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. me çmim 3.000.000 lekë. Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se njësia e shërbimit është dhënë me qira nga prindërit ndër vite dhe ka paraqitur kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 29.04.2011, me afat 5-vjeçar, duke vënë në dispozicion mandatpagesat për derdhjen e qirasë. Gjithashtu, ASHK - Tiranë ka informuar se në emër të prindërve të subjektit rezulton e regjistruar edhe një pasuri e llojit “arë” me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Tiranë, me sip. 448 m<sup>2</sup>, përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.11.2001, kundrejt çmimit 1.000.000 lekë. Po ashtu, për të provuar mundësinë financiare të prindërve për blerjen e pasurive, ka vënë në dispozicion në përgjigje të pyetësorit nr. 1, dokumentacionin për kryerjen e pagesave të tatimeve dhe sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në shtetin grek të prindërve, duke filluar nga viti 2002 e në vijim.

<sup>6</sup> Gjithashtu, ASHK Tiranë ka informuar se në emër të prindërve të subjektit rezulton e regjistruar edhe një pasuri e llojit “tokë-arë” me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Tiranë, me sip. 448 m<sup>2</sup>, përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.11.2001, kundrejt çmimit 1.000.000 lekë. Po ashtu, për të provuar mundësinë financiare të prindërve për blerjen e pasurive, subjekti vuri në dispozicion dokumentacionin për kryerjen e pagesave të tatimeve dhe sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi i prindërve në shtetin grek, duke filluar nga viti 2002 e në vijim.



të subjektit si gjyqtar/stazhier, si dhe duke pasur në vëmendje mungesën e ndonjë kontributi financiar nga ana e subjektit – i cili asokohe ishte ende student – çmohet se nuk kanë rezultuar arsye të mjaftueshme për kryerjen e hetimeve/verifikimeve lidhur me burimet financiare të krijimit të pasurisë në fjalë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, vetëm për faktin se ky apartament është përdorur prej tij.

12. Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në përdorim nga ana e tij në deklaratën *Vetting*.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

13. Në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dërguara subjekti ka informuar se mosdeklarimi ka qenë keqkuptim i ligjit nga ana e tij, pasi ka menduar se meqenëse pasuria ka qenë në pronësi të prindërve, ajo nuk do të ishte objekt hetimi, pasi prindërit nuk kanë qenë në përbërjen familjare me të prej vitit 2013. Po ashtu, ai nuk ka pasur qëllim për ta fshehur si pasuri, për aq kohë sa ka depozituar me pyetësinorin edhe kontratën e shitblerjes së vitit 2009, për këtë pasuri.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

14. Për sa më sipër ka shpjeguar në prapësimet e dërguara, por edhe nga rezultatet e hetimit administrativ, nga ku nuk rezulton ndonjë kontribut financiar në blerjen e pasurisë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ dhe se nuk evidentohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

### **3. Llogari në “Raiffeisen Bank”**

15. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare pranë “Raiffeisen Bank”, në masën 136.153 lekë, në datën 31.12.2016. “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari disponon llogarinë e pagës dhe një *overdraft* në vlerën 240.000 lekë. Kjo e fundit është deklaruar prej subjektit në rubrikën e detyrimeve të deklaratës *Vetting*, ku ka specifikuar se kjo shumë është e papërdorur prej tij.
16. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë bankare në fjalë ka rezultuar se përputhet gjendja e llogarisë së deklaruar prej subjektit, si dhe është konfirmuar burimi i ligjshëm i kësaj shume me të ardhurat nga paga e tij.

### **REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE**

17. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e të cilave mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

18. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2015, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit, pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, siç është detajuar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 2015 – 2016**

	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>-74,191</b>	<b>142,355</b>
Ndryshim likuiditeti	-74,191	142,355
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>-2,928</b>	<b>139,426</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>
Kredi pranë Raiffeisen Bank		
Kredi pranë FiBank	100,000	
<b>PASURI NETO</b>	<b>-174,191</b>	<b>142,355</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>553,625</b>	<b>971,748</b>
Të ardhura të subjektit	553,625	971,748
<b>SHPENZIME</b>	<b>609,801</b>	<b>460,152</b>
Shpenzime jetese	224,276	235,092
Shpenzime kredie	64,705	45,574
Shpenzime udhëtimi	121,820	80,486
Shpenzime mjekësore	99,000	99,000
Shpenzime arredimi	100,000	
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>118,015</b>	<b>369,242</b>
Gjendje cash në banesë në lekë		
Gjendje në llogaritë bankare	-2,928	139,426
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>		<b>0</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

19. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari.

20. Me shkresën e datës 26.4.2022, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikime të kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit. Në vijim të kërkesës së Komisionit të datës 8.6.2022, për një përditësim dhe deklasifikim të raportit të tyre, DSIK-ja, me shkresën e datës 13.7.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin e sipërcituar të deklasifikuar plotësisht me vendimin e datës 12.7.2022 të KDZH-së.

21. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

22. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime, të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLGJ -ja**

23. Raporti nr. \*\*\*, datë 14.7.2021, i përcjellë nga KLGJ-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (b) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (c) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
24. Rezulton se subjekti nuk ka paraqitur të dhëna për punësimin e tij në periudhën tetor 2013 – tetor 2016, pasi sipas formularit të vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari, në periudhën tetor 2010 - shtator 201, ka ushtruar detyrën e juristit në ish-Komunën \*\*\*, të Rrethit Korçë dhe në periudhën shtator 2011 – shtator 2013 ka qenë në detyrën e juristit në ish-Komunën \*\*\*, të Rrethit Korçë, ndërsa në tetor të vitit 2013 ai ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë.
25. Sipas të dhënave nga formulari i vetëdeklarimit rezultoi se subjekti Artan Jahollari, në periudhën tetor 2013 - tetor 2015, ka qenë student në Shkollën ne Magjistraturës. Sipas

shkresës nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Artan Jahollari në periudhën tetor 2015 - gusht 2016 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (ku ka kryer stazhin profesional) dhe ka punuar në Dhomën Civile.

26. Ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016, si dhe me Dekretin nr. \*\*\*<sup>7</sup>, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.
27. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore<sup>8</sup> dhe në pesë dosjet<sup>9</sup> e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon shumë mirë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtari ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor, vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre; (iii) gjyqtari ka njohuri akademike shumë të mira dhe i shfaq ato në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (iv) vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej gjyqtarit Artan Jahollari janë të qarta dhe të kuptueshme; (v) vendimet civile të dhëna prej tij ose nuk ankimohen nga palët ose ankimohen dhe lihen në fuqi nga gjykatat më të larta.
28. Subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari, në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016), ka punuar gjithsej një vit. Në periudhën tetor 2013 - tetor 2015, ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa në periudhën tetor 2015 - gusht 2016 ka punuar si gjyqtar provizor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ka kryer stazhin profesional. Në periudhën gusht 2016 - tetor 2016 ka qëndruar në periudhë pritjeje për të marrë emërimin përfundimtar si gjyqtar, emërim të cilin e ka marrë me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
29. Gjatë kohës së stazhit profesional të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën tetor 2015 - gusht 2016, gjyqtarit Artan Jahollari i janë caktuar 124 çështje

---

<sup>7</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, bashkëlidhur Dekretin Nr. \*\*\*, viti 2015, i Presidentit dhe ka informuar se nuk disponon dekret tjetër të vitit 2017.

<sup>8</sup> Vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 18.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 26.4.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 30.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>9</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 9.3.2016; çështja penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 24.3.2016; çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 4.3.2016; çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 25.1.2016 dhe kërkesa penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 19.5.2016.

penale e civile. Nga ky volum çështjesh të marra për gjykim gjyqtari ka përfunduar së gjykuari 122 çështje gjithsej, duke mbartur vetëm 2 çështje<sup>10</sup>.

30. Subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara dhe të analizuara. Kështu, dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore/pajtimimit apo gjyqësore. Konstatohet se në 2 çështje civile themeli të vëzhguara, njëra prej tyre familjare, gjyqtari ka kryer rregullisht veprimet përgatitore apo të pajtimimit. Veprimet përgatitore janë dokumentuar rregullisht me procesverbal, po ashtu aftësi shumë të mira janë konstatuar edhe në gjykimet penale.
31. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk janë konstatuar të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Artan Jahollari edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

## **C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE I KRYER NGA KOMISIONI**

32. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionin e marrë nga denoncimet nga publiku të administruara për këtë qëllim.
33. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional me nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021, për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, përgjithësisht nuk vërejt problematika të natyrës procedurale apo etike dhe as mangësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, lidhur me këtë subjekt.

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

34. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur gjithsej 16 denoncime nga publiku, prej të cilëve 3 janë përcjellë nga i njëjti shtetas. Këto denoncime janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar më gjerë aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka analizuar dokumentet e administruara, ka konstatuar si vijon:

### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019, i shtetasit K. V.**

---

<sup>10</sup> Sipas të dhënave statistikore të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2019, për efekt të shortit, gjyqtari Artan Jahollari ka përfunduar së gjykuari 124 çështje në periudhën 1.10.2015 – 31.8.2016.

35. Shtetasi K. V. është ankuar për vendimmarrje të gabuar, duke shoqëruar denoncimin e tij me një kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.10.2017, me palë paditës shtetasen Sh. T. dhe palë të paditur shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit H. V., K. V. etj., Referuar shënimit të sekretarisë, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.4.2018, ka lënë në fuqi vendimin e subjektit të rivlerësimit, por me disa ndryshime në pjesën urdhëruese të dispozitivit të vendimit. Në kushtet kur nga ana e denoncuesit ishin përshkruar disa shkelje ligjore, Komisioni, me qëllim thellimin e hetimit, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2022, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2022, vuri në dispozicion<sup>11</sup> dokumentacionin e kërkuar. Në denoncimin e tij, ky shtetas përshkruan shkeljet ligjore të subjektit të rivlerësimit, të pretenduara si vijon:

- a) *Gjyqtari nuk ka respektuar afatin ligjor të marrjes së vendimit për sigurimin e padisë, duke e marrë këtë vendim pa asnjë provë dhe pa asnjë garanci pasurore dhe pa argumente.* Komisionit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit gjyqësor, i ka rezultuar se pala paditëse ka kërkuar dy masa sigurimi padie<sup>12</sup> dhe se të dy vendimet e marra për vendosjen e masës/ave të sigurimit janë marrë brenda afatit ligjor të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile nga subjekti i rivlerësimit<sup>13</sup>. Vendimi është ankimuar nga pala e tretë e thirrur në gjykim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2017, ka lënë në fuqi vendimin e subjektit të rivlerësimit. Nga tërësia e vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit të arsyetuara nga Gjykata e Apelit Korçë vërehet se provat, argumentet dhe rrethanat e çështjes kanë qenë të mjaftueshme për vendimmarrjen e masave të sigurimit të padisë. Nga sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se nuk provohen shkeljet ligjore dhe procedurale të pretenduara nga denoncuesi.
- b) *Gjyqtari shfaq paaftësi profesionale dhe korrupsion, si dhe mungesë të etikës në sallën e gjyqit nga ana e subjektit të rivlerësimit.* Për sa pretendohet për mungesë etike në sallën e gjyqit, Komisioni, referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, por edhe regjistrimit audio të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nuk konstatoi dhe nuk evidentoi ndonjë provë apo ndonjë sjellje jashtë etikës dhe normave të sjelljes së gjyqtarit në ushtrimin e detyrës, në të cilat të mund mbështetej pretendimi i denoncuesit. Për rrjedhojë, Komisioni, arrin në përfundimin se nuk vërtetohet pretendimi i denoncuesit lidhur me mungesën e etikës në sallën e gjyqit.
- c) *Gjyqtari ka nxjerrë jashtë procesit civil ZVRPP-në Pogradec, e cila në padi ishte në cilësinë e palës së paditur.* Referuar objektit të kërkesëpadiisë ka rezultuar se institucioni i ZVRPP-së Pogradec është thirrur nga person i tretë në gjykim. Nga

<sup>11</sup> Dokumentacion dhe kopje të audiove të regjistrimit të seancave gjyqësore.

<sup>12</sup> Masa e sigurimit për moskryerjen e transkriptimit të pasurisë nga ZVRPP-ja Pogradec, kërkesë e përshkruar në objektin e kërkesëpadiisë dhe masa e sigurimit për pezullimin e punimeve nga shoqëria ndërtuese.

<sup>13</sup> Me vendimin e datës 27.4.2017 është marrë vendimi për marrjen e masës së sigurimit për transkriptimin dhe kufizimin, e cila ka qenë objekt padie – vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2017 dhe vendimin për sigurimin e masës së sigurimit “Pezullimin e punimeve nga shoqëria \*\*\*\*” të depozituar në datën 5.7.2017, ku subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 5.7.2017, ka pranuar kërkesën e palë paditëse, duke vendosur pezullimin e punimeve.

shqyrtimi i vendimit, por edhe nga procesverbalet e seancave gjyqësore në dispozicion, ZVRPP-ja Pogradec nuk është paraqitur në seancat e zhvilluara dhe se në datën 15.9.2017 subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për gjykimin e çështjes në mungesë, çka edhe është komunikuar. Nga shqyrtimi i analizimit të bërë në vendim duket se për shkak të gjykimeve të njëpasnjëshme e prej 15 viteve të kërkesëpadisë objekt gjykimi, ky institucion nuk ka pasur një pjesëmarrje në proceset gjyqësore, duke passjellë edhe moszhvillimin normal të çështjeve gjyqësore. Ndodhur në këto kushte, gjyqtari ka paralajmëruar disa herë ZVRPP<sup>14</sup>-në Pogradec me njoftimet përkatëse. Nga sa u përshkrua me sipër, por edhe lidhur me këtë pretendim për shkelje ligjore, Komisioni nuk evidenton shkelje të ligjit procedural, sikurse pretendon denoncuesi.

d) *Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar objektin e padisë pa pasur një kërkesë nga palët.* Nga konsultimi i përmbajtjes së kërkesëpadisë nuk evidentohet që të jetë ndryshuar objekti i padisë në fjalë, përpos kërkesave për sigurimin e padive të kërkuara nga pala. Ky konstatim bazohet në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në përfundim, nisur nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar shkelje të natyrës procedurale apo ligjore nga subjekti i rivlerësimit, sikurse parashtrohet në denoncimin e lartpërmendur.

**2. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020, të shtetasit B. M.<sup>15</sup>**

36. Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të gabuar të vendimit nr. \*\*\*, datë 31.10.2019, duke vendosur “Mospranimin e ankimit të ankuesit B. M., duke lënë në fuqi mosfillimin e procedimit penal datë 30.5.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\* të vitit 2019”, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën e Apelit Korçë. Në denoncimin e tij ky shtetas ka bashkëlidhur edhe një CD audio regjistrimi, nga ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa shkelje procedurale, si vijon:

a) *Gjyqtari, në seancën e datës 31.10.2020, me dashje nuk ka pasqyruar në procesverbal kërkesën për këqyrjen e vendit të pronave “\*\*\*\*” në fund të “\*\*\*\*”.* Nga procesverbali i seancës gjyqësore të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec evidentohet se janë kryer tre aktekspertime nga ekspertët, pavarësisht toponimit dhe emërtimit të denoncuesit në territorin për të cilin ishte ngritur padia, duke dalë të gjithë ekspertët në të njëjtin përfundim për vendndodhjen e pasurisë dhe mbivendosjen e saj.

b) *Gjyqtari ka gjykuar çështjen në kushtet e konflikti të interesit, pasi ai ka gjykuar një tjetër çështje ligjore (me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.3.20219, kundër shtetasit E. M.).* Nga kontrolli i vendimit të vënë në dispozicion, vendimi nuk ka të njëjtin objekt padie dhe palë ndërgjyqëse, sikurse pretendohet nga denoncuesi.

<sup>14</sup> Ndërkohë, nga ana e tij, ky organ/institucion, për këtë çështje objekt gjykimi, ndodhet në disa procese gjyqësore penale me ish-punonjësit.

<sup>15</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=-odLrOherZo>

c) *Gjyqtari nuk ka marrë në konsideratë provat e depozituara nga emisioni investigativ \*\*\*. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, pala paditëse është shprehur mbi filmimet dhe transkriptimin e emisionit për të cilin edhe gjyqtari ka argumentuar dhe arsyetuar qartësisht po në të njëjtën seancë gjyqësore të zhvilluar. Vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 31.10.2019, duke pranuar ankimin e shtetasit B. M., duke anuluar vendimin e Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar në vendim se: “ ... vendimi është i cekët dhe i paarsyetuar, pasi vendimi është përshkrim i fakteve që kanë rezultuar se hetimi dhe se Gjykata e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej shkaqeve të ankimit, duke trajtuar në mënyrë tërësisht të gabuar objektin e kallëzimit penal dhe të ankimit kundër mosfillimit të procedimit penal”. Po ashtu, gjykata, duke vijuar në arsyetim, shprehet se: “...nuk është orientuar dhe angazhuar në hetimin e mëtejshëm të dokumentacionit të përcjellë nga kallëzuesi, si dhe ka gjetur të gabuar qëndrimin e gjykatës se nuk ka pasur vend për detyrimin e ekspertit ligjor të kryejë hetime të mëtejshme ... etj”.*

37. Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me vendimin e dhënë, pasi në të nuk janë përshkruar arsyet për të cilat gjykata ka vlerësuar të papranueshme provat e depozituara, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje shteruese të gjitha shkaqeve të kallëzimit të denoncuesit, sipas përcaktimit në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

38. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara, por edhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, ka shpjeguar së pari se thelbi i pretendimeve të kallëzuesit B. M. ka konsistuar në drejtim të planvendosjes së dokumentit që ka shoqëruar vendimin e KKKP-së për palën kundërshtare A. Q., ka qenë i falsifikuar dhe, si i tillë, ky dokument nuk duhej administruar nga gjyqtari i Korçës B. Sh., duke e arsyetuar gjerësisht këtë argument në pikën 48 të vendimit nr. \*\*\*, datë 31.10.2019.

39. Po ashtu, ekspertët topografë e kanë nxjerrë pronën e palës kundërshtare A. Q. në arat e gjata ku ka pronën kallëzuesi, ndërkohë që testamenti që ka bërë trashëgimlënësi i palës kundërshtare ka kufitarë që e nxjerrin pronën në vend tjetër, argument i analizuar në vendim në pikën 49 të vendimit nr. \*\*\*, datë 31.10.2019. Po ashtu, zëri kadastral i tokës së ndarë me ligjin nr. 7501 është cilësuar nga gjyqtari si tokë truall, ndërsa pronat përreth ku e ka kallëzuesi është tokë bujqësore, argumente gjithashtu të analizuar gjerësisht në pikën 50 të vendimit nr. \*\*\*, datë 31.10.2019.

40. Në vendimin nr. \*\*\*, datë 31.10.2019, kallëzuesit i janë dhënë shpjegime në lidhje me të kallëzuarin B. Sh., gjyqtar në Korçë, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Po ashtu në vendim është arsyetuar gjerësisht se gjyqtari nuk mund të merret në përgjegjësi penale për mënyrën sesi vlerëson provat në gjykim, të argumentuara në pikat 1-27 të vendimit. Gjithashtu është analizuar në lidhje me pretendimin e kallëzuesit së është kryer vepra penale “falsifikim i dokumenteve”, në



pikat 28 - 46 të vendimit, duke bërë një analizë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë mënyrën e marrjes së provës kur pretendohet se është e falsifikuar, duke analizuar rolin e gjykatës se deri në çfarë shkalle mund të ndërhyjë në lidhje me aktekspertimet që janë shqyrtuar në një gjykim civil të përfunduar me vendim të formës së prerë.

41. Analizimi i pretendimeve të kallëzuesit në mënyrë konkrete është arsyetuar në pikat 47 - 60 të vendimit, ku në pikat 51 dhe 59 të tij i është dhënë përgjigje pretendimit të kallëzuesit për pretendimin në pikën 50, duke referuar edhe në vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke u shprehur se vendi ku është ndarë toka bujqësore me ligjin nr. 7501 nuk është e tillë, pasi aty ka qenë fusha e aviacionit. Në pikat 54 - 58 të vendimit i është dhënë përgjigje pretendimit të kallëzuesit për pretendimin e treguar në pikën 48 të vendimit, duke arsyetuar se planvendosja është bërë në vendndodhjen e treguar nga pala kundërshtarë, çka nuk do të thotë se është e falsifikuar. Në gjykimin civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë janë kryer tri aktekspertime dhe po të tria kanë nxjerrë të mbivendosur pronën e kallëzuesit me atë të palës kundërshtarë, duke i dhënë përgjigje pretendimit të kallëzuesit në pikat 49 dhe 58 të vendimit. Fakti që kufitarët e përmendur në testament nuk janë të njëjtë me kufitarët që ndodhen në terren të pronës, nuk do të thotë se kemi falsifikim të akteve.
42. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2020, ka prishur vendimin nr.\*\*\*, datë 31.10.2019, dhe ka urdhëruar kryerjen e hetimeve të mëtejshme. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, pas kryerjes së hetimeve të mëtejshme, ka kërkuar përsëri në gjykatë pushimin e çështjes penale, e cila është në gjykim, provuar kjo me vërtetimin datë 23.11.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
43. Gjithashtu, denoncuesi B. M. është një palë tepër problematike dhe kjo e bën të vështirë menaxhimin e tij. Bashkëlidhur prapësimeve janë vënë në dispozicion vërtetimi i datës 23.11.2022, në lidhje me kërkesën e Prokurorisë për “Pushimin e procedimit penal”; kërkesa e Prokurorisë, kërkesa për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes; si dhe vendimi i Kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë për pranimin e heqjes dorë nga shqyrtimi i çështjes.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

44. Nisur nga shpjegimet dhe dokumentacioni i administruar i përcjellë me prapësimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në vendimin nr. \*\*\*, datë 31.10.2019, është argumentuar dhe arsyetuar përgjithësisht nga subjekti i rivlerësimit, duke analizuar lidhur me përgjegjësinë penale, për mënyrën se si merren provat, rolin e gjykatës, por edhe në mënyrë të përmbledhur me atë çka ka qenë edhe pretendimi i kallëzuesit.
45. Ndërsa, për sa i takon vendimit të prishur nga Gjykata e Apelit Korçë, trupi gjykues i është referuar dokumentacionit të paraqitur me prapësimet, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka kryer hetime të mëtejshme dhe ka arritur po në të njëjtin rezultat, duke kërkuar pushimin e çështjes penale, e cila, referuar vërtetimit është ende në gjykim. Në përfundim, trupi gjykues çmon se rezultati i arritur dhe i njoftuar subjektit nuk ndryshon, për sa kohë argumentimi dhe arsyetimi i vendimit nuk ka qenë shterues dhe jo

gjithëpërfshirës, si dhe arrin në përfundimin se duke qenë se ky rast mbetet i izoluar – çmon se vetëm kjo rrethanë nuk rezulton e mjaftueshme për ta cilësuar si një mangësi të rëndë apo në një nivel të ulët profesional.

### **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2019, i shtetasit R. D.**

46. Shtetasi R. D., nëpërmjet këtij denoncimi, ka kërkuar analizimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 19.12.2018, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, pasi sipas tij vendimi është marrë në kundërshtim me ligjin dhe me aktespertimin, çka ka sjellë edhe prishjen e objektit të ndërtimit. Komisioni, nga vlerësimi i dokumenteve të administruara dhe i vendimit, konstaton se vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.\*\*\*, datë 25.4.2019. Ndërkohë që nga analizimi procedural i vendimit nuk janë evidentuar shkelje ligjore apo procedurale nga subjekti rivlerësimit, përpos faktit që nga denoncuesi nuk përshkruhen shkelje ligjore të marra në kundërshtim me ligjin. Rrjedhimisht, nuk janë evidentuar *indicie* apo fakte lidhur me të cilat mund të kryhej një hetim i mëtejshëm i thelluar.

### **4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2020, i shtetasit A. K.**

47. Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë për “lirim dorëzim sendi” në shkelje të ligjit, pasi ai nuk ka marrë në konsideratë prapësimet e Bashkisë Pogradec, duke vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.11.2017, pranimin e padisë. Vendimi është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.4.2018. Nga analizimi i vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që Bashkia Pogradec të ketë qenë palë ndërgjyqëse në këtë çështje civile, në mënyrë të tillë që të depozitonte prapësime. Nuk vërtetohen pretendimet e denoncuesit për mosmarrjen në konsideratë të prapësimeve të Bashkisë Pogradec dhe, rrjedhimisht, nuk janë evidentuar *indicie* apo fakte konkrete lidhur me të cilat mund të kryhej një hetim i mëtejshëm.

### **5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2021, i shtetases L. Q.**

48. Kjo shtetase, nëpërmjet formularit të denoncimit, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe një tjetër subjekt, por nuk përshkruan ndonjë shkelje konkrete. Lidhur me subjektin e rivlerësimit shfaq vetëm pakënaqësi në drejtim të vendimmarrjes së tij. Kësisoj Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* për thellimin e hetimit për sa i përket këtij denoncimi.

### **6. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2022 i shtetasit A. M.**

49. Ky shtetas denoncon për vendimmarrje të gabuar të subjektit të rivlerësimit, dhe konkretisht vendimit nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, i cili ka vendosur “Mospranimin e pushimit të kërkuar nga Prokuroria Pogradec” dhe kthimin e akteve për vijimin e hetimeve. Gjithashtu pretendon se gjyqtari ka hequr padrejtësisht nga vendimi emrin e shtetasit V.G., si dhe ka mbajtur qëndrime të ndryshme në vendime të cilat kanë pasur të njëjtin

objekt padie, duke sjellë si shembull vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021<sup>16</sup>. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vënë në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, me palë të kallëzuar A. M. etj., për veprën penale “shpërdorim detyre”, për të cilin është vendosur nga gjykata kthimi i akteve Prokurorisë Pogradec për formulimin e akuzës edhe për anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës. Ky vendim është ankimuar nga personat e kallëzuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2020, ka vendosur: “Ndryshimi i vendimit dhe pushimin e akuzës të veprës penale”.

50. Lidhur me pretendimin se subjekti ka nxjerrë jashtë gjykimit shtetasin V. G., ka rezultuar se ky shtetas ka pasur cilësinë e personit të kallëzuar, lidhur me të cilin gjykata nuk ka gjetur shkelje të shpërdorimit të detyrës, duke e atribuuar kështu konsumimin e veprës penale vetëm në ngarkim të shtetasve të tjerë.
51. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar dhe i vendimit nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec – të marrë nga subjekti i rivlerësimit – pavarësisht faktit se ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Korçë (lidhur me vlerësimin në themel), ku në shqyrtimin e kësaj çështjeje si gjyqtar i seancës paraprake subjekti i rivlerësimit, ka mbetur e paqartë dhe e paidentifikuar pozita procedurale apo përfshirja e shtetasit V. G. (i akuzuar për “shpërdorim detyre” së bashku me shtetasit e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës, për të cilët është kërkuar riformulimi i akuzës). Nga sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime shteruese, për sa më sipër është përshkruar dhe për sa pretendohet në denoncimin në fjalë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

52. Në prapësimet e dërguara, por edhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se në vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, konkretisht në pikat 15 - 26, ka arsyetuar gjerësisht për përgjegjësinë penale të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ku përfshihet edhe denoncuesi si anëtar i këshillit, ndërsa në pikën 25 përshkruhen shkeljet e tyre për veprën penale “shpërdorim detyre”, të cilat gjithashtu jepen në mënyrë të përmbledhur. Për sa i përket administratorit V. G., ky shtetas ka qenë vetëm në cilësinë e përfituesit, sikurse ka arsyetuar, pasi sipas vendimit atij i është rritur paga me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, i është ndërprerë kontrata me qëllim fitimin e dëmshpërblimit, për të cilën ky shtetas ka fituar procesin gjyqësor.
53. Në vendim është shpjeguar dhe argumentuar mbi skemën abuzive të ndërtuar me qëllim për të përfituar shtetasi V. G. dhe, si i tillë, nuk mund të merret në përgjegjësi penale për veprën penale, ashtu sikurse janë marrë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, pasi shtetasi V.G. ka qenë vetëm përfitues për shkak të vendimeve të Këshillit. Në këtë proces, shtetasi V. G. nuk ka pasur cilësi procedurale si i pandehur apo person nën hetim gjatë hetimeve dhe gjykimit. Po ashtu, për të treguar mungesën e tendencës ndaj këtij shtetasi, subjekti

---

<sup>16</sup> Vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor shtetasi është “kundërshtimi i punonjësve të policisë”, ndërsa vepra penale për të cilën është kallëzuar denoncuesi nga prokuroria është “shpërdorim detyre”, vepra të cilat kanë objekt të veprës penale dhe masa ndaluese të ndryshme të parashikuara nga Kodi Penal.

ka shpjeguar se ky shtetas që ka përfaqësuar shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. ka qenë edhe palë e paditur së bashku me shtetasin K. V., që i përket denoncimit nr. 1.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

54. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit edhe gjatë seancës dëgjimore, i vlerëson ato bindëse dhe shteruese.

### **7. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2019, i shtetasit S. R.**

55. Ky shtetas pretendon për shkelje procedurale lidhur me çështjen penale nr. \*\*\*, me të pandehur denoncuesin dhe viktimën A. R., të akuzuar për veprën penale “mashttrim”, po ashtu pretendon se gjyqtari, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.2.2021, ka kryer shkeljet procedurale, si vijon:

a) *Gjyqtari, në kundërshtim me ligjin, nuk e ka thirrur në asnjë nga seancat gjyqësore të zhvilluara nga ky gjyqtar. Nga analizimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, e konkretisht asaj të datës 6.11.2019, ka rezultuar se avokati i palës paditëse (denoncuesit) ka paraqitur kërkesë nëpërmjet email-it të gjykatës për shtyrjen e seancës gjyqësore për arsye shëndetësore. Në këtë kushte, gjyqtari, me qëllim mosbërjen pengesë të zhvillimit të seancave gjyqësore, ka çmuar të caktojë avokatë – denoncuesit nga lista e avokatëve të gatishmërisë, edhe pse rezulton që në seancë të ishte bashkëshortja e tij, por pa dokumentacion ligjor përfaqësimi. Prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës të mos marrë parasysh kërkesën për shtyrje të seancës nga denoncuesi, pasi nuk ka një akt që të vërtetojë pamundësinë e tij shëndetësore për t’u paraqitur në seancë. Nga sa më sipër, Komisionit nuk i rezulton që të vërtetohet pretendimi për mos njoftimin/thirrje në gjykim, për aq kohë sa, ka qenë denoncuesi, ai që ka kërkuar disa herë shtyrjen e seancave gjyqësore.*

b) *Kërkesë për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi i akteve janë evidentuar 6 kërkesa për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, kërkesa që nuk janë pranuar nga gjykata sipas vendimeve të ndërmjetme. Nga shqyrtimi i faqes online të Gjykatës së Apelit Korçë vërehet se vendimi është ankimuar dhe aktualisht çështja është ende në përpunim.*

### **8. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019, i shtetasit R. D.**

56. Shtetasi R. D. ka paraqitur pranë Komisionit (në formë denoncimi) një kërkesë për përjashtimin e subjekti të rivlerësimit Artan Jahollari nga gjykimi i çështjes “pjesëtim pasurie”. Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk hyn në vlerësimin dhe kompetencën e tij, por i nënshtrohet vlerësimit pranë gjykatës kompetente, sipas përcaktimeve të nenit 72 e në vijim, të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile. Për rrjedhojë, nuk shihen *indicie* për hetim të mëtejshëm.

### **9. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.4.20219, i shtetasit M. B.**

57. Ky shtetas denoncon gjyqtarin për vendim të padrejtë, por nuk përcakton ndonjë shkelje ligjore ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili, sipas dokumentacionit ka marrë vendimet nr.

\*\*\*, datë 25.4.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 21.7.2020, për shqyrtimin në seancë paraprake të çështjeve penale për denoncuesin, dhe jo vetëm, të akuzuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” etj., duke vendosur miratimin e kërkesave të prokurorit dhe dërgimin e çështjeve për gjykim themeli. Gjithashtu, Komisioni nuk sheh *indicie* për thellimin e hetimit, për aq kohë sa nuk përshkruhen shkelje procedurale.

**10. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2019, i shtetasit A. S.**

58. Në denoncimin e tij, ky shtetasi denoncon gjyqtarin për korrupsion, por nuk përshkruan asnjë shkelje ligjore. Nuk ka bashkëlidhur asnjë dokumentacion dhe nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, për aq kohë sa nuk ka një informacion dhe nuk përshkruan shkelje ligjore.

**11. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2019, i shtetasit S. S.**

59. Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit për marrje ryshfeti lidhur me caktimin e masës së sigurimit, me detyrim paraqitje për shtetasin L. C., të akuzuar për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve shpërthyes dhe municioni”. Sipas vendimit nr.\*\*\*, datë 15.9.2018, gjyqtari ka dhënë dënimin “detyrim për paraqitje me garanci bankare”, për shtetasin L. C., kur vepra penale parashikon dënimin nga 3 deri në 7 vjet. Nga shqyrtimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 15.9.2018, konstatohet se nga subjekti i rivlerësimit është vlerësuar i ligjshëm arrestimi i shtetasit L. C., për veprën penale “mbajtje pas leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, duke caktuar masën “arrestit me burg”, masë e zëvendësuar me garanci pasurore, parashikuar në nenin 236 të Kodit Penal, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, masë kjo e kërkuar nga mbrojtësi i të arrestuarit, pas verifikimit nga gjyqtari të ekzistencës së kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit. Ky vendim është ankimuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.10.20218, ka vendosur “Miratimin e lënien në fuqi vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit”. Komisioni nuk ka evidentuar shkelje procedurale nga gjyqtari, për aq kohë nuk mund të vlerësojë themelin/shkaqet e ndryshimit të masës, pasi masa e dënimit “garanci pasurore” është e parashikuar si masë zëvendësimi e masës “arrest me burg”, parashikuar nga nenin 236 i Kodit Penal.

**12. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2020, i shtetases S. D. dhe denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020, i shtetases N. D. (A.)**

60. Palët ndërgjyqëse denoncojnë gjyqtarin Artan Jahollari për vendimmarrje të padrejtë të vendimit nr. \*\*\*, datë 21.2.2020, për “Pranimin pjesërisht të padisë së ngritur nga i paditur K. Ç.”. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje procedurale, si:

a) *Ka ndryshuar objektin e padisë më datë 2.10.2019, me vendim dhe pa kërkesë të palës paditëse, as me shkrim, as verbalisht, provuar kjo në procesverbalin audio të seancës datë 2.10.2019 dhe se për këtë veprim ajo ka depozituar një kallëzim penal. Nga analizimi i vendimit ka rezultuar se në datën 2.10.2019 është kërkuar nga denoncuesja të njihej si bashkëpronare e pjesës së mbivendosjes dhe se disa herë është orientuar*

nga gjykata se kjo përbënte shtim të objekti të padisë, moment procedural i relatuar dhe përshkruar në arsyetimin e vendimit të shtimit të objektit të padisë.

- b) *Palët ndërgjyqëse kanë pretenduar se gjyqtari ka përshpejtuar gjykimin dhe nuk ka lënë kohën e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes si palë në proces, por ka vazhduar gjykimin e çështjes dhe nuk ka marrë parasysh raportin shëndetësor dhe kërkesën për shtyrje të znj. S. D.*

Gjykata ka marrë vendimin për gjykimin e çështjes në mungesë të denoncueses, pasi vetë kjo shtetase ka paraqitur disa herë kërkesa për shtyrjen e seancave gjyqësore, duke u bërë shkak për zvarritje të gjykimit edhe duke u paralajmëruar nga gjykata.

- c) *Gjyqtari nuk i ka dhënë palëve mundësi për të bërë pyetje ekspertëve dhe se nuk ka marrë në konsideratë faktin se objekti i gjykimit ka qenë “gjë e gjykuar”. Lidhur me sa pretendohet, Komisioni vlerëson se nuk vërtetohen pretendimet e denoncueses<sup>17</sup>, pasi vetë palët kanë drejtuar shumë herë pyetje ekspertëve të thirrur nga gjykata, ndërsa lidhur me momentin procedural se çështja ka qenë “gjë e gjykuar” rezulton se çështja nuk është ka qenë gjë e gjykuar, pasi ajo ka ardhur nga Gjykata e Lartë, e cila ka dërguar aktet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në vitin 2018.*

61. Nga sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të shprehur lidhur me kallëzimin penal të ngritur ndaj tij nga kjo shtetase, i cili, në përgjigje të këtij pyetësori, ka informuar se palët e përfshira në këtë proces kanë depozituar disa ankesa edhe në ILD. Kjo e fundit, me vendimet<sup>18</sup> e depozituara nga subjekti, ka rrëzuar si të pabazuara ankesat e denoncuesit – të cilat janë të njëjta nga përmbajtja e tyre me denoncimin e sipërcituar. Ndërsa lidhur me kallëzimin penal që kjo shtetase ka bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, ai ka shpjeguar se është vendosur “mosfillimi i procedimit penal”, por se nuk ka informacion nëse është ankimuar dhe se nuk ka njoftim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

### **13. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2022, i shtetasit A. H.**

62. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se ky shtetas ka paraqitur një kallëzim penal në SPAK në datën 28.7.2022 ndaj subjekti të rivlerësimit, me objekt “Moskallëzim krimi, ekspertim i rremë, korrupsion aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose i përkthyesit, shpërdorim detyre në bashkëpunim, korrupsion akti i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë dhe grupi i strukturuar kriminal në bashkëpunim”, si dhe ka ngritur një padi civile ndaj tij me objekt padie “Detyrim i palës së paditur Artan Jahollari të paguajë si dëmshpërblim dëmin pasuror jo kontraktor në masën që do të caktohet nga ekspertët e gjykatës”. Po ashtu, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila vuri në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2020, të subjektit të rivlerësimit që ka pranuar kërkesëpadinë e paditëseve N. Ll. etj., vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2021, është shprehur

<sup>17</sup> Referuar seancës gjyqësore datë 5.11.2019.

<sup>18</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 26.1.2021 (A. D. dhe N. D.); vendimi nr. \*\*\*, datë 4.5.2020 (A. D. dhe S. D.); vendimi nr. \*\*\*, datë 21.4.2021, i KLGJ-së, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2021 të ILD-së.

duke vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Nisur nga sa më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se është regjistruar procedimi penal nr.\*\*\*, datë 29.7.2020, dhe SPAK ka shpallur moskompetencën lëndore dhe me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.7.2020, ia ka dërguar aktet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këtë kallëzim”. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.12.2020, ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2021, ka prishur vendimin e lartpërmendur dhe ka lënë detyrat përkatëse në pjesën arsyetuese.

63. Referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, për sa i takon subjektit të rivlerësimit (faqja 8) citohet se: *“Referuar përmbajtjes së vendimit të mosfillimit të prokurorit dhe vendimit të shkallës së parë që të jetë e argumentuar vendimmarrja për ekzistencën e rrethanave për mosfillimin e procedimit penal ndaj të kallëzuarit Artan Jahollari me detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndërsa nuk argumentohet dhe nuk janë vënë në bisedim faktet e parashtruara në kallëzim ndaj të kallëzuarës B. T. etj.”*. Nga sa më sipër, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin për pjesën që lidhet me gjyqtarin Artan Jahollari dhe ka kërkuar kryerjen e hetimeve vetëm për ekspertin dhe palën paditëse, duke përcaktuar edhe detyra për prokurorin e çështjes në fjalë. Gjithashtu, lidhur me kallëzimin penal të denoncuesit të përmendur, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2020, e cila, me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2022, ka bërë me dije se nuk rezulton që në emër të shtetasit Artan Jahollari të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

64. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar dhe denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pas analizimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, neni 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Artan Jahollari:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Jahollari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 9.12.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*